




Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 07/07/2022
PRIMJENJO:
IN. No. Bt. 02/222



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

Regulllore për ndajten e subvencionëve dhe granteve për ndërmarrjet e vogla dhe të
mesme (NVM), në Komunën e Malishevës

Malishevë, Prill 2022

Në bazë të nenit 11, neni 12 paragrafi 2 shkronja (c), neni 17, neni 24, neni 40, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr 28 e datës. 4. qershor 2008", neni 17, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Rregullës Financiare Nr.01/2013, MF-Shpenzimi i parave publike dhe në bazë të Udhëzimit Administrative nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, në bazë të nenit 10, neni 19 paragrafi 7 shkronja (b,e), neni 40, të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 të datës 12.11.2008, Njoftimit publik Nr.04/280 datë: 13.04.2022, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 28.04.2022 miraton këtë:

Rregullore për ndarjen e subvencioneve dhe granteve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), në Komunën e Malishevës

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret për ndarjen e subvencioneve dhe granteve, mënyra e aplikimit dhe procedurat e ndarjes së mjeteve nga buxheti i Komunës së Malishevës, për biznese aktive dhe START-UP.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për çdo lloj të NVM-ve ose START-UP (biznese fillestare) të regjistruar në Republikën e Kosovës të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Malishevës, me të cilat Komuna lidh marrëveshje për realizimin e projekteve, të cilat i konsideron të një rëndësie të veçantë për realizimin e objektivave strategjike të saj.
2. Kjo rregullore përjashton OJQ-të. Për mbështetjen e kësaj kategorie vlejnë dispozitat e Rregullores Nr.04/2017 Mbi Kriteret ,Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje përkufizimet në vazhdim kanë këtë kuptim:

- 1.1. Aplikues- Çdo lloj i biznesit i regjistruar në Kosovë sipas Ligjit përkatës ;
- 1.2. NVM – ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- 1.3. OJQ – organizatat jo qeveritare;

Neni 4 **Format e ndarjes së subvencioneve dhe granteve**

- 1. Aplikuesi përfitues i subvencioneve dhe granteve sipas kësaj rregullore, përketat me para të gatshme, të cilat palës i transferohen përmes transferimit bankar;
- 2. Format dhe mënyrën e pagesave, e përcakton Drejtoria për Ekonomi, Financë dhe Buxhet në marrëveshjen e lidhur në mes të përfituesit dhe Kryetarit;
- 3. Pagesa kryhet deri në dy kështe;

Neni 5

Kriteret e përgjithshme dhe dokumentet për aplikim

1. Aplikuesi i cili aplikon për subvencione dhe grante në Komunë, duhet të jetë i regjistruara në ARBK;
2. Me rastin e aplikimit, subjektet duhet të paraqesin:
 - 2.1 . Certifikatën e regjistrimit të biznesit me te gjitha informatat përçjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
 - 2.2. Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me A TK;
 - 2.3. Kopjen e lehtëmjoftimit të personit në emër të cilit është regjistruar aplikuesi;
 - 2.4. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është nën hetime;
 - 2.5. Dëshminë e xhirologgarisë aktive të Aplikuesit në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
 - 2.6. Gjendjen e xhirologgarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit. Për Aplikuesit e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme;
 - 2.7. Projekt-propozimin që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare si dhe planin kohor të realizimit të projektit, dhe strukturën organizative të Aplikuesit;
 - 2.9. Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, (e dëshmuar me deklaratë nën betim);
3. Në rast të mos përmblushtjes të ndonjërit nga kriteret specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare;
4. Me rastin e shpalljes të thirrjes publike, Komuna përveç kriterëve të parapara në këtë rregullore, mund të paraqesë edhe kriterë shtesë, konform fushave përkatëse të cilat do të përkrahen;

Neni 6

Kriteret për përzgjedhje

1. Komuna përkrah aplikuesit të cilët janë të regjistruar në ARBK, të cilët me projekt-propozime dëshmojnë që subvencionet-grantet do të ndikojnë në:
 - 1.1.Rritjen e investimeve në territorin e Komunës së Malishevës,
 - 1.2.Rritjen e prodhimitaritë vendore,
 - 1.3.Rritjen e eksportit,
 - 1.4.Promovimin e turizmit,
 - 1.5.Zhvillimin e NVM-ve,
 - 1.6.Rritjen e kapaciteteve konkurruese të NMV-ve
 - 1.7.Hapjen e vendeve të reja të punës.

Neni 7

Publikimi i ftesës dhe mënyra e aplikimit

1. Komuna publikon thirrjen publike për aplikim për subvencione dhe granteve në ueb faqen e saj zyrtare dhe sipas nevojës edhe në mediat e shkruara dhe elektronike, përveç rasteve të veçanta të përcaktuara në nenin 12 të kësaj rregullore.
2. Ftesa- Thirrja publike duhet të jetë e hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.
3. Gjatë kohës kur thirrja publike është e hapur, aplikuesi i interesuar mund të kërkoj sqarime përmes postës elektronike dhe informacione shpeshë përkthazi me thirrjen, por jo më vonë se pesë (5) ditë pune para mbylljes së thirrjes publike.

Neni 8

Procesi i aplikimit

1. Aplikimi për subvencione-grante nga ana e aplikuesit bëhet përmes thirrjes publike.
2. Në thirrje publike përcaktohen kriteret e aplikimit.
3. Të interesuarit, projektet e tyre me dokumentet sipas kriterëve të përcaktuara në nenit 5 të kësaj rregullore dhe kriteret shtesë të përcaktuara në thirrje publike i dërgojnë në Zyren e pranimit të dokumenteve të Komunës në formë fizike dhe me CD.
4. Zyra e pranimit të dokumenteve e bënë protokollimin e dokumentacionit dhe të njëjtën ia dorëzon komisionit të vlerësimit me rastin e formimit.

Neni 9

Komisioni Vlerësues

1. Kryetari i Komunës formon komisionin vlerësues në përbërje prej pesë(5) anëtarëve, në tekstin e mëtejme Komisioni vlerësues.
 - 1.1 Tre (3) anëtar prej të cilëve janë anëtar të rregullt me mandat 1 (një) vjeçar, ndërsa 2 (dy) anëtarët tjerë caktohen të jashtëm, 1 (një) ditë pune pas mbylljes së afatit për aplikim.
2. Përveç anëtarëve të rregullt të komisionit vlerësues nga paragrafi 1 i këtij neni, Kryetari i Komunës duhet të përcaktojë me vendim edhe një (1) anëtarë rezervë me mandat 1 (një) vjeçar, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e komisionit vlerësues i cili ka konflikt interesi apo për arsye tjera nuk mund të jetë prezent në komisionin vlerësues.
3. Anëtarët e emëruar të Komisionit Vlerësues, duhet paraparakisht të sigurohen që pjesëmarrja e tyre në këtë komision është në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar një deklaratë me të cilën deklarojnë se nuk ekziston konflikt interesi.
4. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, apo nëse për arsye tjera nuk mund të jetë prezent në komisionin vlerësues anëtarët duhet të kërkojnë nga Kryetari i Komunës zëvendësimin e tyre.

5. Anëtarë të komisionit vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politik.
6. Komisioni vlerësues në afat prej 10 (dhjetë) ditë pune nga data e mbylljes së thirrjes publike vlerëson aplikacionet nga aspekti procedural dhe vendos nëse aplikuesit i plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara sipas nenit 5 të kësaj rregullore dhe kriteret shtese të përcaktuara në thirrje publike për tu kualifikuar për mbështetje financiare.
7. Raporti përfundimtar me rekomandim për mbështetje financiare duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues.
8. Shuma e mjeteve për përkrahje financiare për përfuttesit e rekomanduar nga Komisioni Vlerësues, aprovon Kryetari i Komunës;
9. Në raste të veçanta, Komisionit vlerësues mund t'i jepet kohë shtesë për vlerësimin e aplikacioneve, nëse një gjë e tillë kërkohet dhe arsyetohet me shkrim nga komisioni vlerësues.
10. Komuna publikon në afat deri 2 (dy) ditë pune pas vlerësimit në ueb-faqe të saj listën preliminare të përfuttesve për subvencione dhe grante. Aplikuesi përfuttes i subvencioneve dhe granteve nuk iu ndahet shuma e mjeteve deri në përfundimin e procedurave të ankesës të përcaktuara në nenin 10 të rregullores.

Neni 10

Komisioni për shqyrtimin e ankesave

1. Kryetari i Komunës themelon Komision për shqyrtimin e Ankesave, në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve të rregullt që kanë përvojë dhe integritet dhe i cili ka për mandat shqyrtimin e ankesave të aplikantëve.
2. Përveç anëtarëve të rregullt të komisionit të ankesave nga paragrafi 1 i këtij neni, Kryetari i Komunës duhet të përcaktojë me vendim edhe një (1) anëtarë rezervë me mandat 1 (një) vjeçar, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e komisionit të ankesave i cili ka konflikt interesi apo për arsye tjera nuk mund të jetë prezent në komision.
3. Kundër vlerësimit të komisionit vlerësues, aplikuesi mund të ushtroj ankesë pranë komisionit për shqyrtimin e ankesave.

4. Anëtarët e emëruar të Komisionit të Ankesave duhet paraprirakisht të sigurohen që pjesëmarrja e tyre në këto komisione është në përputhje me legjisllacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar një deklaratë me të cilën deklarojnë se nuk ekziston konflikti i interesit.
5. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, apo nëse për arsye tjera nuk mund të jetë prezent në komision, anëtarët duhet të kërkojnë nga Kryetari i Komunës zëvendësimin e tyre.
6. Aplikuesi që nuk është përfshirë në listën preliminare të përfutësve për subvencione dhe grante, mund të ankohen në Komisionin për shqyrtimin e ankesave, brenda afatit prej 8 (tetë) ditëve pune pas publikimit të listës preliminare.
7. Përbërja e komisionit caktohet me vendim të Kryetari i Komunës. Në Komisionin e Ankesave nuk mund të marrin pjesë anëtarët të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtimin e aplikacionit në kuadër të Komisionit Vlerësues dhe të emëruarit politik.

Neni 11

Miratimi i kërkesave

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim në bazë të rekomandimit të Komisionit vlerësues, me ç'rast përcakton shumën e mjeteve për përkrahje financiare për financimin e projektit të përzgjedhur nga kjo kategori sipas neni 9 paragrafi 8 i kësaj rregullore, pas përfundimit të afateve të përcaktuara në nenin 10 të kësaj rregullore.
2. Kryetari i Komunës dhe përfutësi, lidhin marrëveshje për ekzekutimin e subvencionit-grandit.

Neni 12

Financimi dhe bashkë-financimi përmes subvencioneve dhe granteve

Komuna ka të drejtë të lidhë marrëveshje me përfutësin vendorë dhe ndërkombëtar për realizimin e projekteve, të cilat Komuna i konsideron të rëndësishë së veçantë, si: konferenca, forume, panaire, takime biznes me biznes si dhe forma të tjera të ndërlihdura me aktivitetet e përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregullore.

Neni 13

Kufizimet financiare dhe kohore

1. Çdo projekt i financuar nga Komuna duhet t'i respektojë kufizimet financiare dhe kohore mbi bazën e marrëveshjes.
2. Kryetari i Komunës me vendim mund të mbështesë projektin e aplikuesit maximum deri 70 % .
2. Komuna ndan subvencione dhe grante duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për Vitin fiskal për të cilën ndahen subvencionet-grantet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.

Neni 14

Monitorimi i realizimit të projektit

1. Monitorimi i realizimit të projekteve/marrëveshjeve bëhet nga një zyrtar anëtar i komisionit monitorues apo nga komision monitorues që caktohet nga Kryetari i Komunës. Një zyrtar monitorues propozohet nga Drejtoria për Ekonomi, Financë dhe buxhet;
2. Zyrtari ose komisioni monitorues kanë për obligim të përgatisin raport përmbledhës për realizimin e projektit. Zyrtari apo anëtarët e komisionit monitorues nuk mund të jenë anëtarët e komisionit vlerësues apo anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesave.

Neni 15

Procedura e mbylljes së projekteve

1. Përfutjesi i subvencioneve-granteve, pas realizimit të projektit është i obliguar të dorëzojë në Komunë një raport përshkruues financiar së bashku me faturat për shpenzimet e krijuara gjatë realizimit të projektit.
2. Afati kohor i dorëzimit të raportit financiar sipas paragrafit 1 të këtij neni, përcaktohet në marrëveshjen mes Komunës dhe aplikuesit.
3. Zyrtari apo komisioni monitorues i projektit pas pranimit nga përfutjesi të dokumentacionit për përfundimin e projektit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, e kontrollon atë nëse është realizuar apo jo projekti sipas marrëveshjes.

4. Pas verifikimit të dokumentacionit të projektit nga zyrtari apo komisioni monitorues, raporti përfundimtar sipas paragrafit 1 të këtij neni, dërgohet në Drejtorin për Buxhet dhe Financa.
5. Në rast të evidentimit të shkeljes së marrëveshjes nga përfutesi, zyrtari/ komisioni monitorues raporton te ZKA, duke rekomanduar për hapat e mëtejme.
6. Në rast se përfutesi I subvencionit-grantit të pranuar nga Komuna nuk arrin të realizoj qëllimin e projektit konform marrëveshjes për mbështetje, përfutesi do të obligohet të kthej shumën e pranuar të mjeteve në të tësi ose pjesën e mbetur të pa realizuar konform marrëveshjes.
7. Në rastet e shkeljeve të rënda të marrëveshjes, Kryetari i Komunës mundë të nxjerr vendim për anulimin e marrëveshjes dhe të ndërmer masa për iniciimin e procedurës në Gjykatën kompetente

Neni 16

Konflikti i interesit

1. Zbatimi i kësaj rregullore duhet të bëhet duke respektuar legjislacionin në fuqi për shmangje të konfliktit të interesit.
2. Në rast se një anëtar i Komisionit Vlerësues, komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe komisionit monitorues konstaton se ai/ajo ka një konflikt interesi, duhet të deklarojë konfliktin dhe nuk duhet të marr pjesë në procesin e vlerësimit, procesin e ankesave dhe monitorimit. Në rast të tillë, anëtari i tërhequr nga procesi duhet të respektojë deklaratën e nënshkruar nën betim për ruajtjen e konfidentalitetit sipas paragrafit 5 të nenit 9 të kësaj rregullore.
3. Zyrtarët të cilët janë të përfshirë në përgatitjen e specifikacionit apo detyrave për thirrjet publike për dhënien e subvencioneve-granteve nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit Vlerësues.

Neni 17

Ndryshimi dhe Plotësimi

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës,

me propozimet e arsyetuara nga propozuesi.

Neni 18

Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, kjo Rregullore hynë në fuqi, sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në fagen zyrtare të Komunës së Malishevës.

Malishevë, Prill 2022

Kryesues i Kuvendit

Argjent Hjaçi





REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS

DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCË DHE
BUXHET

NJËSIA PËR KOMUNIKIM PUBLIK



PRILAPSE
ACCEPTED ON 13/04/22
PRILAPSE
NR. 04/280

Komuna e Malishevës përmes ekipit punues për hartim të **Projekt- RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE DHE GRANTEVE PER NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME (NVM)**, duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Malishevës dhe Nenin 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/20218. për Konsultime Publike, Rregullores për Transparencë të Komunës së Malishevës

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me konsultimin e **Projekt- RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE DHE GRANTEVE PER NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME (NVM)**, ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 13.04.2022 deri me datën: 27.04.2022.

Komentet dhe propozimet e juaja mund t'i dërgoni deri, më datën 16.03.2022, në ora 16:00 tek përgjegjësit, në formë fizike ose në e-mail adresat e zyrtarëve përgjegjës:

komuna.malisheve@rks-gov.net, kkmalisheve@gmail.com, artan.pacarizi@rks-gov.net,
izet.b.shala@rks-gov.net, blerta.d.krasniqi@rks-gov.net, Xhevdet. Mazreku@rks-gov.net

Për më shumë detaje për **Projekt- RREGULLOREN PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE DHE GRANTEVE PER NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME (NVM)**, mund ta gjeni në linkun e ueb faqes zyrtare të Komunës së Malishevës: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/dokumente/konsultime-publike/>, si dhe në platformën online të konsultimeve publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/>

Malishevë, 13.04.2022

Dretori për Ekonomi, Financë dhe Buxhet

Blerim Phaci